



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 3055/2 Prot.

Tiranë, më 30 / 3 /2026

UDHËZIM

Nr. 3056, datë 30 / 3 /2026

P Ë R

PROCEDURËN E SELEKSIONIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE PËR KUOTAT E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË MJEKËSI ME MBËSHTETJEN E MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 13, pika 2, shkronja "f", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 77 dhe 78 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Rregullores në fuqi të Specializimeve Afatgjata në Mjekësi dhe vendimit të Senatit Akademik të UMT për miratimin e kuotave të pranimit; dhe të pikës 4 të Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. _____, datë ___ / ___ / _____ "Për miratimin e modeleve të kontratës për kryerjen e specializimit afatgjatë në mjekësi me kuotë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shërbimin e detyrueshëm në FA",

U D H Ë Z O J:

**KREU I
OBJEKTI DHE FUSHA E ZBATIMIT**

**Neni 1
Objekti**

Ky udhëzim përcakton procedurën e vlerësimit dhe seleksionimit paraparak të kandidatëve për programet e Specializimeve Afatgjata në Mjekësi, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT), që do të mbështeten për aplikim me kuotat e parashikuara për Ministrinë e Mbrojtjes (MM).

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

Ky udhëzim zbatohet për të gjitha kërkesat për mbështetje të Ministrisë së Mbrojtjes për kryerjen e programeve të specializimeve afatgjata në mjekësi, të paraqitura nga:

- a) personeli ushtarak dhe civil aktiv i Forcave të Armatosura (Kategoria A);
- b) shtetasit civilë jashtë radhëve të Forcave të Armatosura (Kategoria B).

Neni 3

Kërkesat për programe pa kuota të miratuara

Kërkesat për mbështetje për programe specializimi për të cilat nuk janë parashikuar kuota për programe Specializimi Afatgjatë në Mjekësi për Ministrinë e për vitin akademik përkatës nuk merren në shqyrtim. Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) i njofton aplikantët me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës, duke shpjeguar arsyen e mospranimit dhe duke i informuar për programet e specializimit për të cilat janë parashikuar kuota për Ministrinë e Mbrojtjes.

KREU II AFATET PROCEDURALE

Neni 4 Kalendari i procedurës

1. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit zyrtar të UMT-së për kuotat e miratuara dhe afatet e aplikimit, DBNJ shpall hapjen e aplikimeve, duke përcaktuar programet e Specializimeve Afatgjatë në Mjekësi për të cilat janë miratuar kuota për Ministrinë e Mbrojtjes, numrin e kuotave dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit.
2. Kandidatët dorëzojnë dokumentacionin e plotë pranë DBNJ-së brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e shpalljes.
3. Komisioni i Vlerësimit kryen shqyrtimin e dosjeve dhe vlerësimin me gojë brenda 5 (pesë) ditëve pune nga mbyllja e afatit të dorëzimit të dokumentacionit.
4. DBNJ njofton me shkrim kandidatët e kualifikuar dhe ata të skualifikuar brenda 2 (dy) ditëve pune nga vendimi i Komisionit.
5. Kandidatët e kualifikuar nënshkruajnë kontratën individuale para noterit, në datën e njoftuar nga Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS), jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga njoftimi. Letra mbështetëse lëshohet menjëherë pas nënshkrimit dhe noterizimit të kontratës, sipas formatit të përcaktuar nga UMT.
6. Kostoja e noterizimit të kontratës individuale të Modelit 1 (personeli aktiv i FA, civil apo ushtarak) mbulohet nga MM pa kosto për aplikantin, ndërsa kostoja e noterizimit të kontratës individuale të Modelit 2 (civilët jashtë FA) është në ngarkim të aplikantit.
7. Kandidatët të cilët nuk nënshkruajnë kontratën brenda afatit të njoftuar konsiderohen si të tërhequr nga procesi dhe kuota i kalon kandidatit të radhës në listën e vlerësimit.
8. Kur koha e mbetur nga data e njoftimit të kuotave nga UMT deri në datën e parashikuar për dorëzimin e aplikimeve pranë UMT-së nuk lejon respektimin e afateve të parashikuara në pikat 1-5 të këtij neni, DBNJ harton një kalendar specifik të deroguar për atë vit akademik dhe ia paraqet për miratim Ministrisë së Mbrojtjes. Kalendari i deroguar miratohet brenda 24 orëve nga paraqitja dhe publikohet menjëherë.

KREU III DOKUMENTACIONI I KANDIDATIT

Neni 5 Dokumentacioni i përbashkët

1. Të gjithë kandidatët, pavarësisht kategorisë, dorëzojnë pranë DBNJ-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë me shkrim drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, me shënimin e programit të specializimit të kërkuar;
 - b) curriculum vitae;
 - c) diplomë universitare (në rastin e diplomave të fituara jashtë vendit dhe dokumentin e njësimit në Republikën e Shqipërisë) dhe listë e notave. Në mungesë të njësimit dorëzohet dokumenti i aplikimit për njësim;
 - ç) certifikatë e njohjes së gjuhës së huaj sipas kërkesave të UMT-së për programin përkatës;
 - d) fotokopje e letërnjoftimit;
 - dh) vërtetim nga UMT që kandidati plotëson kriteret e pranimit për programin e kërkuar, ose deklaratë e kandidatit nën përgjegjësi personale nëse vërtetimi nuk mund të merret brenda afatit;
 - e) vërtetim i gjendjes gjyqësore (pastërti penale);
 - ë) vërtetim mjekësor i aftësisë për kryerjen e specializimit dhe ushtrimin e profesionit mjekësor.
2. Kandidati merr nga DBNJ konfirmim me shkrim të dorëzimit të dokumentacionit, bashkë me listën e dokumenteve të dorëzuara dhe datën e dorëzimit, përfshirë dhe dokumentacionin e parashikuar në nenet 6 dhe 7 sipas rastit.
 3. Dokumentacioni i dorëzuar sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi protokollohet dhe arkivohet pranë MM dhe nuk i kthehet aplikantit. Aplikanti dorëzon dokumentacionin e plotë pranë UMT sipas përcaktimeve në Rregulloret dhe vendimet përkatëse të Senatit Akademik në momentin e aplikimit për programin specializues afatgjatë.

Neni 6

Dokumentacioni shtesë për personelin e FA (Kategoria A)

Personeli i FA, civil dhe ushtarak, përveç dokumentacionit të parashikuar në nenin 5, dorëzon dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) urdhër emërimi ose kontratë aktive shërbimi në FA;
- b) vlerësimet periodike të dy viteve të fundit të shërbimit;
- c) propozim/rekomandim me shkrim nga eprori i drejtpërdrejtë;
- ç) vërtetim zyrtar i viteve të shërbimit aktiv.

Neni 7

Dokumentacioni shtesë për civilët jashtë FA (Kategoria B)

Civilët jashtë FA, përveç dokumentacionit të parashikuar në nenin 5, dorëzojnë dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) letër motivimi me angazhim të qartë dhe të argumentuar për shërbim të detyrueshëm në strukturat shëndetësore të FA-së pas diplomimit;
- b) vërtetim i përvojës profesionale mjekësore pas diplomimit, nëse ka;
- c) deklaratë e kandidatit, nën përgjegjësi të plotë juridike, se nuk ka paraqitur kërkesë për të njëjtin program specializimi dhe vit akademik pranë institucioneve të tjera.

KREU IV KOMISIONI I VLERËSIMIT

Neni 8 Ngritja dhe përbërja

1. Komisioni i Vlerësimit ngrihet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes për çdo vit akademik. Përbërja orientuese e Komisionit është si vijon:
 - a) Drejtori i Burimeve Njerëzore;
 - b) Drejtori Inspektori Shëndetësor i Forcave të Armatosura;
 - c) Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë ose përfaqësuesi i autorizuar;
 - ç) Përfaqësuesi i Drejtorisë Juridike të Ministrisë së Mbrojtjes;
 - d) Anëtarë të tjerë të përcaktuar në urdhrin e ngritjes së Komisionit.
2. Komisioni përbëhet nga numër tek anëtarësh me të drejtë vote. Komisioni është i vlefshëm kur janë të pranishëm të paktën 3 (tre) anëtarë me të drejtë vote. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë. Në rast barazie votash vendos kryetari.

Neni 9 Detyrat e Komisionit

1. Verifikon plotësinë dhe vlefshmërinë e dokumentacionit të çdo kandidati.
2. Kryen vlerësimin me gojë të të gjithë kandidatëve që kalojnë verifikimin formal.
3. Pikëzon kandidatët sipas kriterëve të nenit 11.
4. Harton renditjen përfundimtare dhe listën e kandidatëve të kualifikuar dhe të skualifikuar.
5. Harton procesverbal për çdo seancë vlerësimi, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët dhe ruhet pranë DBNJ-së.

KREU V MEKANIZMI I VLERËSIMIT

Neni 10 Faza e parë — Verifikimi formal

Komisioni verifikon nëse dokumentacioni i çdo kandidati është i plotë sipas parashikimeve të neneve 5, 6 dhe 7 të këtij udhëzimi. Kandidatët që nuk i plotësojnë këto kushte skualifikohen dhe njoftohen me shkrim nga DBNJ. Vetëm kandidatët që kalojnë fazën e parë hyjnë në vlerësim.

Neni 11 Faza e dytë — Pikëzimi

Çdo kandidat vlerësohet me maksimum 100 pikë sipas kriterëve të mëposhtme, të ndryshme sipas kategorisë. Kandidatët që nuk arrijnë pragun minimal prej 60 (gjashtëdhjetë) pikësh nuk kualifikohen, edhe nëse numri i kuotave të disponueshme mbetet i pambushur. Mesatarja përlllogaritet sipas metodologjisë së përdorur nga UMT për Specializimet Afatgjata në Mjekësi.

11.1 Kategoria A — Personeli aktiv i FA (100 pikë totale):

Kriteri i vlerësimit	Pikë maksimale
Mesatarja e studimeve universitare <i>Formula: (Nota mesatare - 4) × 6 (maksimum 36 pikë)</i>	36
Vlerësimi periodik i dy viteve të fundit të shërbimit <i>I shkëlqyer: 20 pikë / Shumë mirë: 15 pikë / Mirë: 10 pikë / Mjaftueshëm: 5 pikë</i>	20
Vitet e shërbimit aktiv në FA <i>1 pikë për çdo vit të plotë, maksimum 14 pikë</i>	14
Vlerësimi me gojë nga Komisioni <i>Motivim, njohuri mjekësore, angazhim për shërbim në FA</i>	30

11.2 Kategoria B — Civilët jashtë FA (100 pikë totale):

Kriteri i vlerësimit	Pikë maksimale
Mesatarja e studimeve universitare <i>Formula: (Nota mesatare - 4) × 7 (maksimum 42 pikë)</i>	42
Vlerësimi intervistës me gojë nga Komisioni <i>Motivim, njohuri mjekësore, seriozitet i angazhimit për shërbim në FA</i>	35
Letër motivimi (vlerësuar nga Komisioni) <i>Shkëlqyer: 13 / Mirë: 9 / Mjaftueshëm: 5 / Dobët: 0</i>	13
Përvoja profesionale mjekësore pas diplomimit <i>1 pikë për çdo 6 muaj të plotë, maksimum 10 pikë</i>	10

Neni 12

Faza e tretë — Renditja dhe ndarja e kuotave

1. Komisioni harton dy lista të veçanta renditjeje: një për Kategorinë A dhe një për Kategorinë B. Në listë përfshihen vetëm kandidatët që kanë arritur prapun minimal prej 60 pikësh.
2. Kuotat e miratuara ndahen fillimisht për kandidatët e Kategorisë A, sipas renditjes. Brenda Kategorisë A, ushtarakët aktivë kanë përparësi ndaj personelit civil aktiv të FA-së. Kuotat e mbetura pas shterimit të listës së Kategorisë A i kalojnë kandidatëve të Kategorisë B sipas renditjes.
3. Në rast pikësh të barabarta brenda të njëjtit grup: përparësi ka kandidati me mesatare universitare më të lartë; nëse mesataret janë të barabarta, vendos shorti i kryer publik nga Komisioni.
4. Komisioni harton gjithashtu një listë pritëse me kandidatët e kualifikuar por të papërzgjedhur, sipas renditjes, e cila aktivizohet automatikisht kur një kandidat i përzgjedhur tërhiqet ose nuk nënshkruan kontratën brenda afatit.

KREU VI ANKIMIMI

Neni 13
E drejta e ankimit

1. Kandidati ka të drejtë të ankimojë pikëzimin dhe renditjen e shpallur nga Komisioni brenda 24 orëve nga shpallja pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Sekretari i Përgjithshëm shqyrton ankimin dhe nxjerr vendim brenda 2 (dy) ditëve pune nga paraqitja e tij.

KREU VII
DISPOZITË KALIMTARE

Neni 14
Parashikime specifike për vitin akademik 2025–2026

14.1 Afatet që aplikohen për vitin akademik 2025-2026

Për shkak të afateve të procesit të pranimit të UMT-së për vitin akademik 2025–2026, procedura e seleksionimit për këtë vit akademik ndjek kalendarin e deroguar të mëposhtëm:

Hapi procedural	Afati
Kandidatët që kanë aplikuar paraqesin dokumentacionin pranë DBNJ-së dhe marrin konfirmim me shkrim të dorëzimit dhe listën e dokumenteve të pranuar	Deri më 01.04.2026, ora 14:00
Vlerësimi nga Komisioni: Faza 1 - shqyrtim dosjesh	Brenda datës 01.04.2026
Vlerësimi nga Komisioni: Faza 2 dhe 3 – vlerësimi me gojë, pikëzimi dhe renditja	02.04.2026, ora 09:00
Shpallja publike e rezultateve në praninë e kandidatëve dhe njoftimi i kandidatëve fitues për orën dhe vendin e nënshkrimit të kontratës	02.04.2026, ora 15:00
Nënshkrimi i kontratës individuale para noterit	03.04.2026
Lëshimi i letrave mbështetëse nga MM kandidatëve	03.04.2026, ora 17:00
Përcjellja me shkresë zyrtare UMT-së e listës së kandidatëve fitues të mbështetur nga MM	Brenda datës 07.04.2026

14.2 Derogime në lidhje me dokumentacionin

Konsideruar afatet e parashikuara në pikën 14.1, dokumentet që duhet të dorëzojë aplikanti të e parashikuara në shkronjat "ç", "dh", "e" dhe "ë" të nenit 5, shkronjën "ç" të nenit 6, si dhe shkronjën "b" të nenit 7, mund të zëvendësohen me vetëdeklarim të kandidatit, nën përgjegjësinë e tij të plotë juridike dhe penale, i cili vërteton plotësimin e kushteve përkatëse. Deklarim i pavërtetë i aplikantit përbën shkelje të deklaratës dhe aktivizon penalitetin maksimal sipas kontratës.

Vërtetimi i viteve të shërbimit aktiv i parashikuar në shkronjën "ç" të nenit 6, nëse kandidati nuk e disponon brenda afatit, kërkohet drejtpërdrejt nga DBNJ pranë strukturës përkatëse të FA-së.

14.3 Derogime në lidhje me ankimimin

Ankimimet në lidhje me pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve dorëzohen jo më vonë se data 03.04.2026 ora 10.00 në MM. Sekretari i Përgjithshëm vlerëson ankimimin dhe i kthen përgjigje kandidatit brenda orarit zyrtar më datë 03.04.2026.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Dispozita të fundit

1. DBNJ është struktura përgjegjëse për koordinimin e të gjithë procesit të seleksionimit, komunikimin me UMT-në dhe administrimin e dokumentacionit.
2. Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë cakton datën, orën dhe vendin e nënshkrimit të kontratave individuale dhe njofton kandidatët e kualifikuar.
3. Çdo akt i mëparshëm i Ministrisë së Mbrojtjes që rregullon procedura të ngjashme seleksionimi për specializimet afatgjata në mjekësi shfuqizohet.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

MINISTRI

Ermal Nufi

